



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. 485/12 prot.

Tiranë, më 21. 2.2019

Lënda: Njoftim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës.

**ORGANIZATAVE PËRFAQËSUESE SINDIKALE**

Baza ligjore: Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 159 e vijues i Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë” ( i ndryshuar).

Me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave, interesave ekonomike, profesionale dhe sociale të punonjësve, lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës dhe ushtrimin e veprimtarisë sindikaliste si dhe duke marrë shkas nga kërkesa për lidhjen e kontratës kolektive pranë Posta Shqiptare sh.a., nga ku synojmë ndalimin e diskriminimit padrejtësisht, sigurimin e besimit dhe transparencës për këtë procedurë si dhe trajtimin e barabartë të organizatave sindikale që mund të shprehin interes për lidhjen e marrëveshjes kolektive të punës, Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a.:

Fton të gjithë Organizatat Përfaqësuese Sindikale të interesuara të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në adresën: **Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë (Zyra e Protokollit)**, brenda 2 (dy) javëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi:

1. Kërkesën me shkrim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive;
2. Statutin e Sindikatës;
3. Aktin e Themelimit;
4. Vendimin e Gyrkatës lidhur me regjistrimin si person juridik të organizatës;
5. Treguesit mbi përfaqësueshmërinë. (në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës sindikale , në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti konsiderohet si kusht për skualifikim.

Më tej, do të procedohet, me publikimin e kërkesave duke i afishuar në vende të dukshme, në ambientet e Drejtorisë së Filialeve/Degëve dhe Zyrave Postare.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

